

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim lejohej pagesa e mjeteve financiare për Isa Bajramin në shumën prej 180 € (njëqindetëtdhjetë euro), për shkak të gjendjes së vështirë shëndetësore.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor –subvencione- Zyra e Kryetarit të Komunës.
3. Mjetet derdhen në xhirlogarinë bankare të Isa Bajrami [REDACTED]
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionimin e përfituesit.
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.


Vendimi i dorëzohet:

- Palës
- DBF dhe
- Arkivit

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni





KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Komunës së Gjilanit, si autoritet publik

dhe

Isa Bajrami, përfitues

Gjilan, 2023

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për Isa Bajramin, për shkak të gjendjes së vështir shëndetësore, sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren 01. nr. 016-126422 dt. 29.12.2016 e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren nr. 2/208,01 nr. 016-28468 dt. 22.03.2018 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 21 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2)

Neni 2
Vlera e Subvencionimit

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej 180 € (njëqindetëdhjetë euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor- Subvencione –Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 3
Obligimet e palëve

1. **Obligimet e përfituesit të subvencionit janë :**
 - 1.1. mjetet e marra, përfituesi do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet e paraqitura në projekt.
 - 1.2. përfituesi duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
2. Përfituesi duhet të sjellë tek Komuna e Gjilanit:
 - 2.1. raportin narrativ (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
 - 2.2. njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit

Neni 4

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:
 - 1.1. obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje, t'ia transferoj në xhironlogarinë bankare të përfituesit sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2. bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilanit mban të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

Neni 5
Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Shkëputja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:
 - 1.1. tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2. marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
 - 1.3. shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
 - 1.4. mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

Neni 7
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt, përfituesi është i obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 10

Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.


Komuna e Gjilanit
Alban Hyseni, Kryetar

Isa Bajrami
ISA
